



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Programi Bashkëpunimi Ndërkufitar IPA Kosovë - Shqipëri 2010-2013

Rishpallje e Konkursit për vend të lirë të punës për pozitën:

Task Menaxher - Sekretariati i Përbashkët Teknik Kukës, Shqipëri (1 pozitë)

Kosova merr pjesë në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Kosovë - Shqipëri 2010 - 2013 i financuar nga Bashkimi Europian. Qëllimi i programit është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave kufitare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Për zbatimin e programit është i themeluar Sekretariati i Përbashkët Teknik me staf nga Kosova dhe Shqipëria, i cili është i vendosur në Kukës, Shqipëri dhe zyra Koordinuese (Antena) e cila është e vendosur në Prizren, Kosovë.

Për të mbështetur zbatimin e Programit të BNK do të punësohet një staf lokal për pozitën:

- **Task Menaxher** (orar i plotë i punës) i cili do të jetë i vendosur pranë Sekretariati të Përbashkët Teknik Kukës, Shqipëri

Detyrat kryesore që do të kryhen përfshijnë:

- Detyrat lidhur me menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e programeve të BNK-së
- Mbështetje në lidhje me shpalljen, kontraktimin, zbatimin e skemave të Grantit për Programin e BNK-së
- Mbështetje për trajnimin e aplikantëve për grandet e financuara nën Programin e BNK;
- Dhënia e asistencës administrative dhe logjistike strukturave të përbashkëta të përcaktuara për zbatimin dhe monitorimin;
- Mbledhje raporte teknike nga përfituesit;
- Ofron asistencë teknike e logjistike ndaj Strukturës Operative dhe Komitetit të Përbashkët të Monitorimit dhe Komitetit të Përbashkët Drejtues;
- Detyra të tjera lidhur me zbatimin e Programit sipas kërkesës së Drejtuesit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

Kualifikimi i kërkuar

- Minimum 3 (tre) vjet përvojë pune;
- Diplomë universitare;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Përvojë praktike e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve;
- Përvoja e mëhershme e punës me programet ndër-kufitare, ose programet/ projektet e BE-së do të shihet si një avantazh;
- Njohuri kompjuterike (MS Office, Internet);
- Aftësi dhe interes personal për të udhëtuar në vendet fqinje dhe në zonat kufitare.

Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin:

- Dëshmi kualifikimi dhe përvojë pune;
- Curriculum Vitae (CV) dhe një Letër motivimi në anglisht;
- Dëshmi që është shtetas i Kosovës;
- Formulari për aplikim i MAPL-së, shqip dhe serbisht (<http://mapl.rks-gov.net/getattachment/f9414385-3174-46fd-bfcf-4601a37665f3/Shkarko-Aplikacionin.aspx>)

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/Divizioni i Burimeve Njerëzore, Adresa: Objekti Qeveritar (ish objekti i "Rilindjes") kati i XII zyrja nr.1203 prej orës 08:00 deri në 16:00: Aplikacioni mund të tërhiqet nga faqja zyrtare e MAPL-ës "mapl.rks-gov.net", gjithashtu aplikacionet mund të dërgohen me postë në adresën e lartshënuar.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit.

Për informata shtesë rreth aplikimit mund të kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore në tel: 038-200-35-610